144	SHTEPIA KU U MBAJT KONFERENCA E PEZES ne fshatin Peze	PEZË	PEZE		TIRANË	I	Rektorati i Universitetit Shtetëror	6	15.01.1963
145	ISH SHTEPIA E DALIP KARAJ ne fshatin Alltat(Balldushk) -KA QENE NJE NGA BAZAT KRYESORETE E.HOXHES DHE TE SHTABIT TE PERGJITHSHEM	ALLTAT - BALLDUSHK	BALDUSHK		TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	266/1	16.02.1979
146	SHTEPIA MUZE E AVDULLA KETES. lagjia nr.4, Rruga "Bajram Curri", nr.133, Tirane			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	6138/1	31.12.1981
147	SHTEPIA E XHEZMI DELLIT			TIRANË	TIRANË	I	Ministria e Arsimit dhe e Kulturës	2854	8.08.1980
148	RRENOJAT E KISHËS SHËN MËRISË-TUJAN DHE MIRATIMI I ZONES SE MBROJTUR.	BRAR		TIRANË	TIRANË	I	Komiteti i Kulturës dhe Arteve M.T.K.R.S. (MINISTRI)	8 838	18.12.1987 28.08.2008
149	GJURME TE REJA TE KALASE SE TIRANES			TIRANË	TIRANË	I	M.T.K.R.S. (Drejt.Trash.Kulturore.)	652	15.05.2008
150	KALAJA E TIRANES "ZONA ARKEOLOGJIKE"A" DHE RREGULLORJA E ADMINISTRI - -MIT TE SAJ.			TIRANË	TIRANË	I	KESHILLI I MINISTRAVE	1197	03.12.2009
151	BANESA KU KA JETUAR FAMILJA E "NENE TEREZËS" ne rrugen e Kavajes	Rr. e Kavajës		TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. -Drejt. Trashëg.Kulturore	115	15/03/2010
152	KRYEGJYSHATA BOTËRORE BEKTASHIANE (Sella Tirane)			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. -Drejt.e Përgjith. e Turizmit dhe e Trashegimise Kulturore	236	17.05.2010
153	VARRI I NËNËS MBRETËRESHË, Tirane			TIRANË	TIRANË	II	M.T.K.R.S. -Drejt.e Përgjith. e Turizmit dhe e Trashegimise Kulturore	383	16.07.2010

Burimi i Informacionit: *Ministria e Kulturës*

3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zhvillimit te ketij aktiviteti nuk ka burime ujore te identifikuara. Aktiviteti ndodhet ne Rrugen "Mihal Grameno", Tirane dhe nuk ndodhet ne brendesi apo ne afersi te burimeve ujore te rendesishme si Lumenjte kryesore, Liqene, Rezervuar apo Zona Bregdetare. Ne afersi te zones ndodhen vetem disa "Liqene" te vegjel (Rezervuar), si dhe disa "Lumenj" te cilet pershkruajne rajonin e Tiranes, ku ai me i afert me aktivitetin eshte Lumi Lanes rreth 700m ne vije ajrore ne veri te aktivitetit dhe Lumi i Tiranes rreth 3km ne vije ajrore ne veri te aktivitetit. Gjithashtu ne afersi te zones ne vleresim ndodhet Rezervuari i "Liqenit Artificial te Tiranes", rreth 2.7km ne vije ajrore ne jugperendim te aktivitetit dhe "Liqeni i Farkes" rreth 1.3km ne vije ajrore ne juglindje te aktivitetit. Ujoret e Fushëgropës së Tiranës janë: Lumi i Tërkuzës, Lumi i Tiranës, Lumi i Lanës dhe ai i Erzenit. Ata e përshkojnë këtë gjeohapësirë, nga L në P. Si pengesa ujore, në kohën e sotme ato nuk përbëjnë ndonjë problem, gjatë stinës së verës, por në kohë të shirave këto pengesa duhen vlerësuar. Ujëmbledhësit kryesorë janë: i Bovillës që është edhe rezerva e ujit të pijshëm të Tiranës, e cila duhet ruajtur me vigjelencë për rëndësinë e tij jetësore në kohë paqeje dhe lufte. Ai ka një sipërfaqe rreth 4 km². Liqeni i Farkës ndodhet pranë Farkës së Vogël dhe ka një sipërfaqe afërsisht 1 km², me rëndësi ekonomike. Liqeni i Tiranës, rreth 0.8 km² nuk është vetëm një ujor i peizazhit shlodhës të Tiranës, por edhe objekt i rëndësisë së veçantë. Liqeni i

Paskuqanit, ndodhet ne L të Kodër Kamzës ka një sipërfaqe 1.1 km². Rezervuarë të tjerë ka në: Nikël, Kashar, Allgjatë, Berxullë, Picar etj.

Pozicionimi ne lidhje me burimet ujore



Fragment nga Plani Urbanistik i Tirane. Aktiviteti ben pjese ne Njesine Strukturore TR/73



Cilesia e lumenjeve

(Bazuar ne studimin Kombetar vjetor te Agjencise Kombetare te Mjedisit)

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara. Ky program monitorimi me një frekuencë 4 here/ vit siguron një bazë të dhënash të cilat përdoren në hartimin e Raporteve të Gjëndjes së Mjedisit, në hartimin e informacioneve në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar, si dhe raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit.

Gjëndja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene, zona bregdetare dhe stacione pranë impianteve të trajtimit të ujerave të zeza. Të dhënat e monitorimit janë të pjesshme pasi nuk u akordua buxheti i planifikuar për të realizuar programin e monitorimit. Bazuar në Urdhërin e Brendshëm me datë 13.06.2017 me Nr.prot 1464 mbi riorganizimin e procesit të monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore, cilësinë e ajrit urban dhe monitorimin e zhurmave, i cili u pezullua më datë 22.05.2017 për shkak të mungesës së financimit për të realizuar monitorimet e programuara, dhe pas kësaj date u realizuan stacionet me distancë deri në 100km. Vlerësimi paraprak i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE. Për klasifikimin e zonave bregdetare dhe stacionet prane Impianteve të trajtimit të ujërave të zeza i referohemi VKM 177 dt. 31.03.2005 - Normat e lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantet e trajtimit.

Parametrat e analizuar në laborator

- **Nevoja Biokimike për oksigjen** mg/l

Nevoja Biokimike për oksigjen është sasia e oksigjenit të tretur që nevojitet të konsumohet nga organizmat biologjike aerobike të cilat ndodhen në sasinë e kampionit në shishen e pajisur me oxitop. Inkubimi në 20°C realizohet për 5 ditë ku vlera e matur shprehet në mg O/litër. Ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve, tregues i shkallës së ndotjes. Të dhënat e marra për ekspeditat e realizuara janë paraqitur në formë grafike nga ku stacionet të cilat tejkalojnë vleren e lejuar për këtë parametër janë DLe - Drini Lezhë, T2 – Kthesa e Kamzës, L1 – Lanabregas, L2 - Yrshek dhe të tre stacionet e montorimit në Lumin Ishëm si dhe stacioni në Lumin Gjanicë Gj4. Vlerat e larta të këtij parametric dëshmojnë qartë ndikimin e shkarkimeve urbane dhe industriale të cilat derdhen në det të patrajtuara.



♦ Nevoja kimike per oksigjen

Nevoja kimike për oksigjen është tregues i ndotjes kimike dhe organike, ku te dhenat e monitorimit jane paraqitur ne grafikun si vijon.

PËRMBAJTJA E NEVOJËS KIMIKE PËR OKSIGJEN



Në stacionet D1 dhe D3 nuk është vlerësuar ky parametër pasi nuk është kryer për mungesë të Kiteve.

♦ Përmbajtja e amoniakut

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metoden spektrometrike është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU. Në stacionet e monitoruara të ekspeditës së kryer vërejmë tejkalim të vlerës së lejuar të vlerës limite për përmbajtjen e amonjakut në stacionin L2 – Lanabregas me vlerë 25.75 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në klasën V – gjendje e keqe (> 1.5 mg/l), edhe në të tre stacionet e Ishmit kemi tejkalim të vlerës. Stacioni Gj4 – Lumi i Gjanicës paraqet tejkalim të vlerës me një vlerë 2.43 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe (> 1.5 mg/l).



♦ Përmbajtja e nitriteve

Sic vihet re edhe në grafikun e mëposhtëm, përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar. Paraqitja në formë grafiku na jep qartë se vlerat e monitorimit të nitriteve janë të larta por brenda normës limite të lejuar për stacionet T2 – Ura Kthesa e Kamzës dhe Gj4 – Gjanica.



♦ Përmbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar.



♦ Përmbajtja e fosforit

Referuar vlerave të monitorimit të ekspeditës së realizuar, vihet re se tejkalim të vlerave të lejuara për përmbajtjen e orto – fosfateve kemi në stacionin Drini Lezhë me nje vlerë prej 0.306 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – gjendje e varfër, stacioni L2 – Yrshek Ish Dogana ka një përmbajtje 2.79 mg/l Klasa V – Gjendje e keqe (norma > 0.5) stacioni me vlerën më të lartë. Gjithashtu, edhe te tre stacionet e monitorimit të lumit Ishëm jane mbi normën e lejuar dhe në Lumin Gjanicë - Gj4 paraqesin tejkalim të Klasës III – Gjëndje e moderuar.



♦ Përmbajtja e fosforit total

Përmbajtja e fosforit total për ekspeditën e kryer gjatë vitit 2017 paraqitet në grafikun e mëposhtëm ku stacioni Drini i Lezhës është në vlerën kufi të lejuar të Klasës III – gjendje e moderuar, vlerën me të lartë të përmbajtjes së fosforit total është në stacionin L2 – Yrshek Ish Dogana si dhe tre stacionet e Lumit Ishëm jane mbi vlerën e lejuar limite. Edhe ne stacionin Gj4 – Lumi i Gjanicës kemi tejkalim të vlerës limite < 0.4, përmbajtja e fosforit total në këtë stacion është 0.41 mg/l (> 0.4 < 1) gjendje e moderuar – gjëndje e varfër.

Cilësia e ujërave nëntokësorë

Ujerat sipërfaqësorë dhe ata nëntokësorë janë në parim burime natyrore të_rinovueshme. Në veçanti, detyra e sigurimit të gjendjes_së mirë të ujrave nëntokësorë kërkon veprime të përhershme dhe planifikim të qëndrueshëm afatgjatë_të masave mbrojtëse, falë intervalit kohor natyral në_formimin dhe rinovimin e tyre.

Të kryejë monitorimin e ujrave nëntokësore në basenet e Drinit, Matit, Erzen - Ishmit, Shkumbinit, Semanit, Vjosës e Zonës Jonike. Monitorimi synon ruajtjen e tregueseve sasiorë e cilësorë të ujit, të rezervave të shfrytëzimit, mbrojtjen e vendburimeve ekzistuese të ujit, si dhe vlerësimin e shkaqeve të ndotjes së ujrave nëntokësore. Në përfundim të monitorimit jepen rekomandimet për gjendjen aktuale të cilësisë së ujrave, trendet e përmirësimit ose përkeqësimit të cilësisë si masat për mbrojtjen e tyre si zbatimin e zonave të rreptësisë dhe të mbrojtjes sanitare, shkallën e shfrytëzimit etj.

Monitorimi i ujerave nentokesore gjatë vitit 2017 është kryer në 7 basenet ujëmbajtëse për akuiferet porozë të kuaternarit: Shkodër, Lezhë, Fushë - Kuqe, Tiranë, Fushë - Krujë, Elbasan, Lushnjë, Berat, Korcë, Gjirokastër, Kafaraj, Novoselë, Vurg - Mursi e Orikum. Gjithashtu u monitoruan 11 burime kryesore të akuiferit karbonatik në basenin e Drinit - burimi Syri i Sheganit, burimi Gurra e Kolesjanit, burimi Tushemisht, burimi i Linit, në basenin e Matit - burimi i Bargjanës, në basenin e Semanit - burimi i Mançurishtit, burimi i Urës Vajgurore dhe burimi i Bogovës, në basenin e Zonës Jonike - burimi Syri i Kaltër, burimi Uji i Ftohtë Tepelenë dhe burimi Uji i Ftohtë Vlorë. Ky monitorim është kryer sipas Kontratë Porosisë së lidhur ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Mjedisit dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar për vitin 2017.

Monitorimi i ujrave nëntokësore u krye në dy faza monitorimi në basenet ujëmbajtëse të Shqipërise në rrjetin monitorues sipas Kontratës vitit 2017 me analiza të plota kimike dhe analiza për mikroelementë.

VLERËSIMI UN TE BANESAVE 2017

BASENET	NR. PUSIT	VENDNDODHJA	PH	NA	CA	MG	FE	NH4	CL	SO4	NO3	NO2	MP	MTH	FP	VLERËSIMI I UJIT
BASENI I DRINIT	1	St. Shkodrës - Dobraç	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	H	St. Hot I Ri	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	36	St. Velipojë -U. Gjolulit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	3	Kisha e mad-he-Shkoder	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Burimi Syri Sheganit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Burimi Linit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Burimi Tushemisht	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Gumo e Kolesjanit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
BASENI I MATIT	50	St Lezhë - Bar-bullonjë	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	Treques jo te mire kimike - Permbajtje mbi normë të Na, Cl, NO2 vihen re ndotje me nitrite.
	29	St.Shëngjinit - I. Lezhë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	25	Rrlë	VBN	VSLMN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VSLMN	VSLMN	VBN	VBN	VSLMN	VSLMN	VSLMN	Treques jo te mire kimike - Permbajtje mbi normë te Na, Mg, Cl, SO4 Fp, Mp,Mth, - shtesat e poshtme ujembaj-tese, ujë jo i pijshëm.
	46	Hoteli I Gjuetisë	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Treques jo te mire kimike- Permbajtje mbi norme te Na, Cl, NH4
	197	St.Gumëz- Laç	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	176	Milot- Laç	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	177	Patok- Laç	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	Treques jo te mire kim-ike- Permbajtje te larte te Na, Cl - shtesat e poshtme ujembajtese
	500	St.Laçit	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	26	St.Durrësit - Fushë- Kuqe	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Burimi I Bargjanës	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti të mira fiziko - kimike, Përmbajtje mbi normë të Fe dhe NH4.
BASENI I SHKUMBINIT	2/90.	St. Elbasan - Krastë e Madhe	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	3/70.	St. Elbasan - Krastë e Vogël	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	10/A	St. Metalurgjiku - Vidhas	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VLMN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Veti jo te mira fiziko - kimike, ka permbajtje mbi norme Mg,Fp, NH4 me tendence rritje per SO4, Ca.
	3	St. Konjat - Lushnjë	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Veti jo te mira fiziko - kimike, ka permbajtje mbi norme Mg, ndotje NH4, me tendence rritje Fp e Fe.
	286	St.Çerme-Lushnjë	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Veti jo te mira fiziko-kimike, ka permbajtje mbi norme Mg,Fp.
	1D	St.Divjakë-Çermë	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti te mira fiziko-kimike, ka permbajtje mbi norme Mg

VBN = Vlera brenda normave
VBTR = Vlera brenda normave me tendence rritje
VLMN = Vlera te larta mbi norma
VSLMN = Vlera shumë te larta mbi norma

BASENET	NR. PUSIT	VENDNDODHJA	PH	NA	CA	MG	FE	NH4	CL	SO4	NO3	NO2	MP	MTH	FP	VLERËSIMI I UJIT
BASENI I ERZEN - ISHMIT	13	St.Kombinat- Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti të mira fiziko - kimike, tendence rritje e Fp
	1P	St. Selitë-Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Veti të mira fiziko - kimike, tendence rritje e NH4, NO3.
	16/97	Rr. Kavajës - Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti të mira fiziko - kimike, tendence rritje e NH4, NO3.
	6	St. Laknas - Tiranë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti te mira fiziko-kimike- Tendencë rritje të Ca, Mg, NO3, Fp
	47	St. Bërxull - Tiranë	VBN	VBN	VBTR	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VLMN	Veti te mira fiziko-kimike- ka fortesi te larte mbi norme, tendence rritje te Ca, Mg, Mp.
	2/97	Rinas - Fushë - Krujë	VBN	VBN	VBTR	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	Veti shume te mira fiziko-kimike. Tendence rritje te Ca, Fp.
	160	St.Thumanë - Fushë-Krujë	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Veti shume te mira fiziko-kimike. Tendence rritje te Ca, Fp.
	1 N	St.Gramëz- Gramëz	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo te mire kimike- ka fortesi te larte, permbajtje mbi norme te Mg, ndotje me NO2,
	327	St.F.Krujë-F.Krujë	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VLMN	Tregues jo te mire kimike- ka fortesi te larte, permbajtje mbi norme te Ca, Mg
BASENI I SEMANIT	3	St. Korçë -Turan	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shume te mira fiziko-kimike, me tendence rritje Mg, NH4.
	108	St.Bulgarec	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko-kimike, me tendence rritje Mg.
	173/1	St.Shegeras	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shume të mira fiziko-kimike, Ndotje mbi lartë NH4.
	1v.	I.Terova	VBN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti te mira fiziko-kimike- ka permbajte mbi norme te Mg, me tendencë rritje të nitrateve - perdorur per vaditje
	Burim	Burimi Mançurisht	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shume te mira fiziko-kimike.
	83	Banaj	VBN	VBN	VBN	VLMN	VLMN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, Mg, NH4, me tendence rritje të fortësisë.
	St.	Arrez	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, Mg, NH4, me fortësi mbi normë.
	St.	Çiflig	VBN	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Fe, me tendence rritje të fortësisë, Mg, NH4, NO2.
	St.	Kozare	VBN	VBN	VBN	VSLMN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp metendencë rritje NH4, SO4.
		Otllak	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp me tendencë rritje Ca, NO3.
		Lapardha 2	VBN	VBN	VBTR	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	VBN	VLMN	Tregues jo të mirë kimike - përmbajtje mbi normë të Mg, Fp me tendencë rritje Ca, NO3.
	Burim	Bogovë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Ura Vajgurore	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike

VBN = Vlera brenda normave
VBTR = Vlera brenda normave me tendence rritje
VLMN = Vlera te larta mbi norma
VSLMN = Vlera shumë te larta mbi norma

BASENET	NR. PUSIT	VENDNDODHJA	PH	NA	CA	MG	FE	NH4	CL	SO4	NO3	NO2	MP	MTH	FP	VLERËSIMI I UJIT
BASENI I VJOSES	P.V	St.Gjirokastër Eduk	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	St.B	Budrishtë - Gjirokastër	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Shp.	Vanistër	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	St.N	St.Novoselë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike, me tendencë rritje Mg.
	St.K	St.Kafaraj	VBN	VBTR	VBN	VSLMN	VBN	VBN	VLMN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBTR	Tregues jo të mira kimike - ka Mg, Cl mbi normë, me tendencë rritje Na dhe Mp,Fp.
	St.	Pish-Poro	VBN	VSLMN	VBN	VSLMN	VBN	VSLMN	VSLMN	VBN	VBN	VBN	VLMN	VLMN	VLMN	Tregues jo të mira kimike- Na, Mg, Cl, NH4 mbi normë, të larta, Mth, Mp , Na.ujë i papijshëm.
BASENI I ZONES - JONIKE	Vrion	St.Vrion-Sarandë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Karahaxh	St.Karahaxh-Sarandë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Mursi	St.Mursi-Sarandë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBTR	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike, me tendencë rritje Cl.
	Orikum	St.Orikum-Vlorë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Syri I Kaltër	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
	Burim	Uji I Ftohtë -Vlorë	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	VBN	Veti shumë të mira fiziko - kimike
STASH 3004-88(P.M.L)			6,5-9,5	20-100	75-200	20-50	0.2 - 0.3	ni-0,05	25-200	25-250	25-250	ni-0,05	1200			500-100010-25(30)
E.C. 80/778 (P.M.L.)			6,5-9,5	20-150	100	30-50	0.05-0.2	0,05-0.5	25	25-250	25-250	ni-0,1				1500,0 >50

VBN = Vlera brenda normave
VBTR = Vlera brenda normave me tendence rritje
VLMN = Vlera te larta mbi norma
VSLMN = Vlera shumë te larta mbi norma

Burimi i informacionit: *Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2017, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombetare e Mjedisit (Faqja Zyrtare).*

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
Parimi i qasjes së integruar
Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit
Parimi "Ndotësi paguan"
Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera;
b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkime ne uje

Ky aktivitet nuk shoqerohet me shkarkime ne ujerat e ndotura, pasi nuk perdor uje ne procesin e punes, nuk kemi larje te mbetjeve inerte, nuk prodhon uje. Shkarkime te ujerave te perdorura mund te jene vetem ato te kullimit te ujerave te shiut ne sheshin e instalimit te impiantit te cilat do te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te ujerave te bardha te zones.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga produktet e magazinuar, nga procesi i thyerjes dhe bluarjes se mbetjeve inerte, pasi eshte nje proces qe ndodh ne te thate. Zhurmat mund te jene nje burim tjeter shqetesimi, por ato pershkruhen ne paragrafin e meposhtem. Shkarkimet spontane, nuk vleresohen me ndikime te rendesishme ne mjedis dhe ne komunitetin e

zones. Pervec pluhurit te ngritur ne ajer nga era dhe gjate proceseve te punes ne kete ambjent, mund te vleresohen edhe gazet qe shkarkohen nga makinerite e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit. Per eleminimin e pluhurave duhet te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithe kohes.

Zhurmat dhe vibrimet

Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga proceset e punes qe zhvillohen ne kete kantier. Mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues. Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nuk do te shkaktohen vibrime.

Ndikimi ne toke

Proceset e punes nuk do te ndikojne ne toke, por zenia e nje siperfaqe toke nga instalimi dhe magazinimi i mbetjeve inerte, eshte tashme nje fakt dhe nuk ndryshon gje vleresimi ne kete faze. Aktualisht, nuk demtohet me tej bimesia, nuk demtohet relievi as struktura e tokes, pasi nuk ka ndryshime ne instalim, as zgjerim te siperfaqes.

Ndikimi ne Biodiversitet

Sipas verifikimeve ne portalin asig.gov.al, kjo zonë nuk bënë pjesë në zonat e mbrojtura me ligj, as lloji i aktivitetit nuk ndikon ne biodiversitetin e mjedisit tokesor. Aktiviteti ndodhet ne nje zone pa bimesi dhe larg burimeve ujore.

Ndikimi ne Mjedisin Social

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, do te jete pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te shitjes se materialeve inerte per ndertim. Objekti nuk duhet te funksionoje ne nje zone te rrezikuar nga permbytjet, te rrezikuar nga zjarret (sic jane pyjet), nuk duhet te kete akses askush i paautorizuar dhe duhet te kete siguri fizike.

Mbetjet e prodhuara

Mbetje te ngurta qe do te prodhohen do te jene ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem. Mbetjet inerte si copa betoni, apo asfalti perdoren si materiale te dores se dyte, per mbushje te shtreses se poshtme te rrugeve. Mbetjet që prodhohen gjatë punimeve të prishjes apo ndërtimit të objekteve apo rrugëve të përcaktuara sipas projektit, janë shënuar si më poshtë me kodet përkatëse bazuar në Vendimin Nr. 99, datë 18.02.2005 "Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve":

17 01 01	Beton
17 01 02	Tulla
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika
17 03 02	Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01
17 05 04	Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03
17 05 08	Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07

5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.
Ky aktivitet nuk shoqerohet me shkarkime ne ujerat e ndotura, pasi nuk perdor uje ne procesin e punes, nuk kemi larje te mbetjeve inerte, nuk prodhon uje. Shkarkime te ujerave te perdorura mund te jene vetem ato te kullimit te ujerave te shiut ne sheshin e instalimit te impiantit te cilat do te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te ujerave te bardha te zones.
Emetimet ne ajer nga ky instalim vijne kryesisht nga pluhuri i cili mund te ngrihet nga faktoret klimatike nga produktet e magazinuar, nga procesi i thyerjes dhe bluarjes se mbetjeve inerte, pasi eshte nje proces qe ndodh ne te thate. Zhurmat mund te jene nje burim tjeter shqetesimi, por ato pershkruhen ne paragrafin e meposhtem. Shkarkimet spontane, nuk vleresohen me ndikime te rendesishme ne mjedis dhe ne komunitetin e zones. Pervec pluhurit te ngritur ne ajer nga era dhe gjate proceseve te punes ne kete ambjent, mund te vleresohen edhe gazet qe shkarkohen nga makinerite e ngarkim-shkarkimit dhe nga transportuesit e materialit. Per eleminimin e pluhurave duhet te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithe kohes.
Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga proceset e punes qe zhvillohen ne kete kantier. Mjetet rrugore dhe zhurma e prodhuar nga vete personat qe punojne per kete aktivitet, nuk vleresohen me potencial ndikues. Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet). Ne kete ambjent nuk vleresohen nivele te tilla zhurme dhe si rrjedhoje edhe keto masa nuk do te jene te nevojshme. Nuk do te shkaktohen vibrime.
Proceset e punes nuk do te ndikojne ne toke, por zenia e nje siperfaqe toke nga instalimi dhe magazinimi i mbetjeve inerte, eshte tashme nje fakt dhe nuk ndryshon gje vleresimi ne kete faze. Aktualisht, nuk demtohet me tej bimesia, nuk demtohet relievi as struktura e tokes, pasi nuk ka ndryshime ne instalim, as zgjerim te siperfaqes.
Mbetje te ngurta qe do te prodhohen do te jene ato urbane nga aktiviteti human. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem. Mbetjet inerte si copa betoni, apo asfalti perdoren si materiale te dores se dyte, per mbushje te shtreses se poshtme te rrugeve. Mbetjet që prodhohen gjatë punimeve të prishjes apo ndërtimit të objekteve apo rrugëve të përcaktuara sipas projektit, janë shënuar si më poshtë me kodet përkatëse bazuar në Vendimin Nr. 99, datë 18.02.2005 "Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve":

17 01 01	Beton
17 01 02	Tulla
17 01 03	Tjegulla dhe qeramika
17 03 02	Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01
17 05 04	Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03
17 05 08	Çakëll, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 07

6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi do te zgjase per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti. Ndikimi ne mjedis zgjat per aq ore sa funksionon aktiviteti ne dite dhe aq dite sa ai funksionon ne nje vit.

7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, mund te perhapet ne nje distance fare te ngushte, me dhjetera metra, ose deri ne 100m, kjo persa i perkete ndikimit te zhurmes dhe ndikimit ne ajer. Nuk shkarkohen substanca ose elemente te demshem per mjedisin, si ne ate ujor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin. Nuk ka procese me perdorimin e substancave te demshme. Per parandalimin e ketyre efekteve, subjekti duhet te zbatoje me rigorozitet kushtet teknike. Per eleminimin e pluhurave duhet te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithe kohes.

8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike dhe per mjedisin. Mjedisi i ketij aktiviteti eshte me funksion si Rikuperim i mbetjeve jo te rrezikshme (mbetje inerte qe krijohen gjate prishjes dhe ndertimit te objekteve, rrugeve, etj) dhe magazinim e transportim te tyre per ne pikat e perdorimit te tyre. Ne rast te mbylljes se aktivitetit, mund te merret ne konsiderate mundesia e rehabilitimit te plote te siperfaqeve dhe kthimin e peizazhit ne gjendjen e mepareshme. Per kete subjekti duhet te hartoje nje plan mbyllje te aktivitetit, qe duke u nisur nga strukturat e perkohshme, nuk paraqitet me kosto te larta.

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Ne menyre te pergjithshme paraqesim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori ose nenkontratuesit per zbatimin e projektit. Ndikimet negative ne mjedis gjate zbatimit te projektit jane ne nivele te konsiderueshme. Keshtu qe gjykojme se jane teper te nevojshme qe ne vija te pergjithshme te kihen parasysh dhe te ndermerren disa masa nga kompania. Keto masa renditen ne listen e rekomandimeve te meposhteme:

- Duhet te punohet sipas rregullores se kushteve teknike, nuk duhet te lejohen derdhje te karburanteve dhe lendeve te tjera djegese ne mjedisin e aktivitetit, pasi ndotin ambjentin dhe mund te jene burim aksidenti e shkaktar te zjarreve te pa deshiruara e me tej mund te shkaktoje edhe shperthime.
- Ne sheshin e aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme.
- Mjetet rrugore qe qarkullojne duhet te jene konform normave te percaktuara dhe te testuara nga Qendra e Kontrollit Teknik te automjeteve e te pajisura me certifikaten perkatese.
- Punëtorët që do të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin duhet të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit (Kufje ose tapa per veshet).
- Te rehabilitohet siperfaqja perreth objektit, duke u gjelberuar dhe duke krijuar nje efekt ndihmes ne reduktimin e zhurmes dhe te pluhurit.
- Te aplikohet lagia e kantierit me uje gjate gjithe kohes per eleminimin e pluhurave.
- Te shtrohet me asfaltobeton sheshi i qarkullimit te automjeteve me qellim shmangien e pluhurave dhe depertimin e ujerave siperfaqesore ne toke.
- Te mirembahet sheshi i depozitimit te mbetjeve inerte.

10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje ne kushte normale, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar. Per kete kapitull, nuk kryhen vleresime dhe analiza te detajuara per shkak te vendodhjes se projektit ne brendesi te kufirit shteteror dhe distances qe ai ruan me kufirin dhe shtet fqinje.

ANEKS:

Harta Topografike e rajonit. Nomeklatura e Hartes ne shkalle 1:2500 (K-34-100-(12-A)



Koordinatat e aktivitetit ne sistemin: Gaus-Kruger referuar portalit asig.gov.al		
Nr.	**Koordinatat Lindje Y**	**Koordinatat Veri X**
1	**4403544.78**	**4577577.15**
2	**4403560.13**	**4577563.21**
3	**4403573.21**	**4577579.75**
4	**4403557.84**	**4577592.52**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES

QKB
Qendra Kombëtare e Biznesit
National Business Center

Numri serial: **LN-2068-09-2016**
NUIS/NIPT: **L62113034E**

LICENCË

Subjekti: Laert Shehu

Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Njësia Bashkiake nr.4, Rruga Xhanfize Keko, Pallati Andi Konstruksion, Hyrja nr.4, Apartamenti nr.8.

Kodi: III.2.A (1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 13/09/2017

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Vlërësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

Specialiteti

GREEN Solution
TIRANA - ALBANIA

Përmbledhje Jateknike

E vlefshme për subjektin "KONTAKT SHPK" SHPK

"Rikuperim i mbetjeve jo të rezikshme", i ndodhur në Tiranë, Nj. Bashk. 1 alle 2, Rr. Mihal Grameno Z.K. 8180

Nënshkrimi i sportelit: [signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK-TURIZMIT TREGTISË DHE SIPËRMARRJES
QKB
QENDROR
SPORTELI I SHËRBIMIT
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

Kjo çertifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërpritet detyrimi ligjor për të qënë person i tatueshëm.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11659 Prot. Tiranë, më 10.12.2014

Nr. identifikues 262

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kritereve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. LAERT SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

Përmbledhje Jeteknike

GREEN Solution
TIRANA - ALBANIA

MINISTRI

Lefter KOKA

Evlefshme për subjektin "KONTAKT SHAK SHAK"

Rikuperim i mbetjeve jo to rezultshme, i ndodhur no Tiranë, Nj. Bashk. 1 dhe 2, Rruga Mihal Grameno, Z.K. 8180.